



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-115

PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

LIGJ PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllime të këtij ligji;

“Aktivitet afarist” do të thotë çdo aktivitet i cili është ndërmarrë me qëllim të krijimit të fitimit, duke përfshirë shitjen me pakicë, prodhimtarinë, tregtinë, argëtimin, transportin, shërbimet bujqësore, profesionale, specialistike dhe shërbimet e tjera.

“Pasuri kapitale” do të thotë prona e prekshme që mund të shërbejë një vjet ose më tepër.

“Dividendë” do të thotë shpërndarja nga kompania te aksionari:

- e parave të gatshme ose e aksioneve përkitazi me vlerën e mbetur të aksionarit në kompani; dhe
- të pronës tjetër pos parave të gatshme ose aksioneve, përveç nëse prona e tillë shpërndahet si pasojë e likuidimit;

“Punonjës” do të thotë personi fizik, i cili e kryen punën për pagë nën drejtimin dhe kontrollin e punëdhënësit, pavarësisht se a kryhet puna sipas kontratës ose ndonjë forme tjetër të marrëveshjes qoftë e bërë me shkrim apo jo. Shprehja punonjës i përfshin të gjithë zyrtarët publik dhe pjesëtarët e organeve ligjvënese, ekzekutive dhe gjyqësore.

“Punëdhënës” do të thotë çdo person ose subjekt fizik që paguan paga dhe në të përfshihen:

- autoriteti publik;
- organizata afariste;
- organizata e përhershme e personit jo rezident;
- organizata joqeveritare;
- organizata ndërkombëtare, me përjashtim të Kombeve të Bashkuara, agjencive të saj të specializuara dhe Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike dhe
- personi fizik i cili paguan paga gjatë kryerjes së punës në Kosovë;

“Subjekt” do të thotë korporatë ose organizatë tjetër afariste që e ka statusin e personit juridik, organizata afariste që vepron me mjetet në pronësi publike dhe shoqërore, organizata joqeveritare e regjistruar sipas legjislacionit mbi regjistrimin dhe veprimin e organizatave joqeveritare në Kosovë dhe organizata e përhershme e jo rezidentit. Shprehja subjekt nuk e përfshin ndërmarrjen personale të biznesit ose ortakërinë.

“E ardhura nga burimi i jashtëm” do të thotë të ardhurat bruto që nuk janë të ardhura të krijuara në Kosovë.

“Pronë e paprekshme” do të thotë patentet, të drejtat e autorit, lejet, të drejtat ekskluzive dhe prona tjetër që përbëhet vetëm nga të drejtat por që nuk ka formë fizike.

“E ardhura e krijuar në Kosovë” do të thotë të ardhurat bruto që krijohen në Kosovë, si në vijim:

- pagat nga puna e kryer në Kosovë;
- të ardhurat nga aktivitetet afariste në rastet kur aktiviteti i tillë zhvillohet në Kosovë;
- të ardhurat nga shfrytëzimi i pronës së luajtshme dhe të paluajtshme në Kosovë;
- të ardhurat nga shfrytëzimi i pronës së paprekshme në Kosovë;
- interesi në obligimin e borxhit që paguhet nga banori ose autoriteti publik;
- dividendët e paguara nga organizata rezidente e biznesit;

- fitimi nga shitja e pronës së paluajtshme që gjendet në Kosovë; dhe
- të ardhurat e tjera që nuk janë përfshirë në nën-paragrafët e mësipërme të cilat rrjedhin nga aktiviteti ekonomik në Kosovë;

“Vlerë e tregut” do të thotë çmimi me të cilin do të shiteshin mallrat ose shërbimet e ngjashme të cilësisë dhe sasisë së njëjtë në transaksionin duar lirë.

“Person fizik” do të thotë individi.

“Jo rezident” do të thotë çdo person ose subjekt fizik që nuk është rezident, përkatësisht banor i përhershëm.

“Ortakëri” do të thotë ortakëria e përgjithshme, ortakëria e kufizuar ose marrëveshja e ngjashme e bartjes, që nuk është person juridik dhe që në mënyrë proporcionale i ndan zërat e kapitalit, të të ardhurave dhe të humbjeve në mesin e ortakëve.

1A.1 “Ndërmarrje e Përhershme” do të thotë vend i caktuar i veprimtarisë afariste ku veprimtaria afariste e personit jo rezident zhvillohet tërësisht apo pjesërisht në Kosovë.

1A.2 “Ndërmarrje e përhershme” përfshin:

- (a) çdo vend i menaxhmentit;
- (b) çdo degë;
- (c) çdo zyrë;
- (d) çdo fabrikë;
- (e) çdo punëtori;
- (f) çdo minierë dhe
- (g) çdo burim i naftës dhe gazit, gurore ose vend tjetër i shfrytëzimit të burimeve natyrore.

1A.3 “Ndërmarrje e përhershme” gjithashtu përfshin;

(a) çdo vend ndërtimi, ndërtim, montim ose projekt instalimi, ose ndonjë aktivitet mbikëqyrës në lidhje me këtë, por vetëm nëse ndërtimi, projekti ose aktiviteti i tillë zgjat më shumë se njëqindetëdhjetë (183) ditë. Kur vend ndërtimi, projekti ose aktiviteti zgjat më shumë se njëqindetëdhjetë (183) ditë, duke përfshirë edhe aktivitetet përgatitore, vend ndërtimi, projekti apo aktiviteti konsiderohet se ka qenë apo është krijuar si ndërmarrje e përhershme nga dita kur ka filluar puna e tillë;

(b) Ofrimin e ndonjë shërbimi, duke përfshirë shërbime të konsultimeve, por duke përjashtuar aktivitetet e mbikëqyrjes të parapara në nenin 1A.3(a) të kryera në Kosovë nga personi jo rezident përmes punëtorëve ose personelit tjetër, por vetëm nëse aktivitetet e tilla vazhdojnë brenda Kosovës për një periudhë apo periudha gjithsejtë nëntëdhjetë (90) ditore apo më shumë brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore. Kur aktivitetet vazhdojnë brenda Kosovës për një periudhë apo periudha gjithsejtë nëntëdhjetë (90) ditore ose më shumë gjatë një periudhe dymbëdhjetë mujore, aktivitetet konsiderohet se kanë krijuar ndërmarrje të përhershme nga dita kur kanë filluar aktivitetet e tilla;

(c) Çdo vend ndërtimi i shfrytëzuar për kërkimin e resurseve natyrore brenda Kosovës, kur aktivitetet e tilla brenda Kosovës vazhdojnë për një periudhë apo periudha gjithsejtë njëqindetëdhjetë (183) ditore apo më shumë brenda cilësdo periudhe dymbëdhjetë mujore. Kur aktivitetet vazhdojnë për një periudhë apo periudha gjithsejtë njëqindetëdhjetë (183) ditore ose më shumë brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore, aktivitetet konsiderohen se kanë krijuar ndërmarrje të përhershme nga dita kur kanë filluar aktivitetet e tilla; dhe

(d) Çdo pasuri e paluajtshme që ndodhet në Kosovë dhe posedohet nga një person jo rezident.

1A.4 Pavarësisht nga nenet 1A.1 dhe 1A.2 të këtij neni, kur personi, përveç agjentit me status të pavarur për të cilin zbatohet neni 1A.7, vepron në Kosovë në emër të personit jo rezident, personi jo rezident konsiderohet se ka ndërmarrje të përhershme në Kosovë lidhur me aktivitetet që ai person i ndërmerr për personin jo rezident, nëse personi i tillë:

(a) Ka dhe zakonisht ushtron autorizimin në Kosovë për të lidhur kontrata në emër të personit jo rezident, përveç nëse aktivitetet e personit të tillë janë të kufizuara në ato të përmendura në nenin 1A.6 të cilat, nëse ushtrohen përmes një vendi të caktuar të biznesit, nuk do ta bënë këtë vend të caktuar të biznesit ndërmarrje të përhershme sipas dispozitave të atij nën neni; ose

(b) Nuk ka autorizim të tillë, por zakonisht mban një magazinë të mallrave ose materialeve në Kosovë nga i cili vazhdimisht shpërndan mallra ose materiale në emër të tatimpaguesit.

1A.5 Personi jo rezident i cili ofron sigurim, përveç risigurimit, konsiderohet se ka ndërmarrje të përhershme në Kosovë nëse mbledh shpërblime në Kosovë ose siguron rreziqet që ndodhen në Kosovë përmes një personi, përveç agjentit me status të pavarur për të cilin zbatohet neni 1A.7.

1A.6 Pavarësisht nën neneve 1A.1, 1A.2 dhe 1A.3 të këtij neni, “ndërmarrje e përhershme” konsiderohet se nuk përfshin:

(a) Shfrytëzimin e objekteve vetëm me qëllim të ruajtjes ose ekspozimit të mallrave ose materialeve që i përkasin personit jo rezident;

(b) Mbajtja e magazinës së mallrave dhe materialeve që i përkasin personit jo rezident vetëm me qëllim të ruajtjes apo ekspozimit;

(c) Mbajtja e magazinës së mallrave dhe materialeve që i përkasin personit jo rezident vetëm për qëllime të procesimit nga një tatimpagues tjetër;

(d) Mbajtja e një vendi të caktuar të biznesit vetëm me qëllim të blerjes së mallrave ose materialeve ose mbledhjes së informacioneve për personin jo rezident;

(e) Mbajtja e një vendi të caktuar të biznesit vetëm për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të tjera të karakterit përgatitor apo ndihmës për personin jo rezident; dhe

(f) Mbajtja e një vendi të caktuar të biznesit vetëm për kombinimin e ndonjë nga aktivitetet e paraqitura në paragrafin (a) deri (e) të këtij nën neni, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim ka vetëm karakter përgatitor apo ndihmës.

1A.7 Personi jo rezident nuk konsiderohet se ka ndërmarrje të përhershme në Kosovë vetëm pse kryen veprimtari afariste në Kosovë përmes komisionerit, agjentit të përgjithshëm të komisionit apo ndonjë agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që personat e tillë veprojnë sipas rrjedhës së rëndomtë të biznesit të tyre.

Mirëpo, kur aktivitetet e agjentit të tillë kushtohen tërësisht apo gati tërësisht në emër të atij taksapaguesi, dhe krijohen kushtet apo imponohen ndërmjet atij taksapaguesi dhe agjentit në marrëdhëniet e tyre komerciale dhe financiare që ndryshojnë nga ata që do të kishin mundur të bëhen ndërmjet taksapaguesve të pavarur, ai nuk konsiderohet agjent me status të pavarur në kuptimin e këtij nën neni.

1A.8 Fakti se personi jo rezident kontrollon ose kontrollon nga një kompani që është rezidente e Kosovës, apo që kryen biznes në Kosovë (qoftë përmes ndërmarrjes së përhershme apo ndryshe), nuk e konsideron asnjëherë kompani ndërmarrje të përhershme të tjetrës.

“Person” do të thotë person ose subjekt fizik.

“Ndërmarrje afariste personale” do të thotë një person fizik që merret me një afarizëm, i cili nuk është agjent ose punonjës i ndonjë aktiviteti tjetër afarist.

“Punëdhënës kryesor” do të thotë punëdhënës i përcaktuar si i tillë nga punonjësi në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar me një udhëzim administrativ që do të lëshohet nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

“Autoritet publik” do të thotë çdo autoritet qendror, rajonal, komunal apo vendor, organ publik, ministri, departament ose autoritet tjetër që ushtron kompetenca publike ekzekutive, legjislative, rregulluese, administrative apo gjyqësore.

“Person i afërt” do të thotë personat që kanë lidhje të posaçme dhe që kjo mund të ndikojë materialisht në rezultatet ekonomike të shitblerjes ndërmjet tyre. Lidhjet e posaçme shkaktohen kur:

- personat janë zyrtarë ose drejtorë të afarizmit të njëri-tjetrit;

- personat janë ortakë në afarizëm;
- personat janë në lidhje punëdhënës-punonjës;
- një person mban ose kontrollon 50% apo më shumë të aksioneve ose të të drejtave të votimit të personit tjetër juridik;
- një person e kontrollon personin tjetër në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- të dy personat kontrollohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga personi i tretë; ose
- personi është bashkëshort a bashkëshorte apo janë të afërt të shkallës së tretë gjithëpërfshirëse ose miq deri në shkallën e dytë gjithëpërfshirëse;

“Shpenzimet e përfaqësimit” do të thotë të gjitha shpenzimet e lidhura me përkrahjen e afarizmit ose prodhimet e tij dhe i përfshin shpenzimet për publicitet, reklama, argëtim e përfaqësim;

“Banor” do të thotë:

- personi fizik i cili ka vendbanim kryesor në Kosovë ose është fizikisht i pranishëm në Kosovë brenda njëqindetëdhjetetë (183) ditëve apo më shumë gjatë çdo periudhe të tatimit; ose
- subjekti që është themeluar në Kosovë apo që e ka vendin e tij të menaxhimit efektiv në Kosovë.

“Personi “i vetëpunësuar” do të thotë çdo person fizik i cili punon për përfitim personal, me para të gatshme ose me mallra, i cili nuk përfshihet në përkufizimin e punonjësit sipas këtij ligji. Personi i vetëpunësuar e përfshin ndërmarrjen afariste personale dhe ortakun e angazhuar në aktivitet afariste;

“Periudhë e tatimit” do të thotë vit kalendarik.

“Pagë” do të thotë kompensimi financiar ose llojet e tjera të kompensimit, duke i përfshirë mallrat, favoret, shërbimet ose shkëmbimet që paguhet në lidhje me punësimin në Kosovë.

Neni 2 Tatimpaguesit

Sipas këtij ligji tatimpaguesit janë personat fizikë, banorë dhe jo banorë të cilët pranojnë ose krijojnë të ardhura bruto të përshkruara në nenin 6 të këtij ligji gjatë periudhës së tatimit.

Neni 3

Objekti i tatimit

1. Objekti i tatimit për tatimpaguesin banor janë të ardhurat e tatueshme nga burimi i të ardhurave nga Kosova dhe burimi i të ardhurave nga jashtë.
2. Objekti i tatimit për tatimpaguesin jo banor janë të ardhurat e tatueshme nga të ardhurat që e kanë burimin në Kosovë.

Neni 4

Të ardhurat e tatueshme

Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme do të thotë ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranura ose të krijuara gjatë periudhës së tatimit dhe zbritjet e lejueshme sipas këtij ligji lidhur me të ardhurat e tilla bruto.

Neni 5

Shkallët e tatimit

1. Për secilën periudhë tatimore, tatimi në të ardhura ngarkohet sipas shkallëve në vijim:
 - 1.1. për të ardhurat e tatueshme nëntëqindegjashtëdhjetë (960) euro ose më pak, zero për qind (0%);
 - 1.2. për të ardhurat e tatueshme mbi nëntëqindegjashtëdhjetë (960) euro deri në tremijë (3.000) euro, katër për qind (4%) të shumës mbi nëntëqindegjashtëdhjetë (960) euro;
 - 1.3. për të ardhurat e tatueshme mbi tremijë (3.000) euro deri në pesëmijekatërqind (5.400) euro, tetëdhjetenjë pikë gjashtë (81.6) euro plus tetë për qind (8%) të shumës mbi tremijë (3.000) euro; dhe
 - 1.4. për të ardhurat e tatueshme mbi pesëmijekatërqind (5.400) euro, dyqindeshtatëdhjetetë pikë gjashtë (273.6) euro plus dhjetë për qind (10%) të shumës mbi pesëmijekatërqind (5.400) euro.

Neni 6

Të ardhurat bruto

1. Me përjashtim të të ardhurave që lirohen sipas këtij ligji, të ardhurat bruto do të thotë të gjitha të ardhurat që pranohen ose shtohen nga të gjitha burimet, duke i përfshirë:
 - 1.1. pagat;

- 1.2. aktivitetet afariste;
- 1.3. qiratë;
- 1.4. shfrytëzimin e pronës së paprekshme;
- 1.5. interesin;
- 1.6. dividendët;
- 1.7. fitimet kapitale;
- 1.8. lotaritë dhe lojërat e tjera të fatit;
- 1.9. pensionet që i paguan qeveria, punëdhënësi i mëparshëm, ose në pajtim me ligjin për Pensionet në Kosovë, dhe
- 1.10. të gjitha të ardhurat e tjera që e rrisin vlerën neto të tatimpaguesit.

Neni 7

Të ardhurat që përjashtohen

1. Nga tatimi në të ardhura personale përjashtohen këto të ardhura në vijim:

- 1.1. rrogat e pranuar nga përfaqësuesit e huaj diplomatik e konsular dhe personeli i jashtëm i Zyrave të Ndërlidhjes në Kosovë, siç është përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/42 të datës 10 qershor 2000 mbi themelimin dhe funksionimin e Zyrave të Ndërlidhjes në Kosovë;
- 1.2. rrogat e pranuar nga përfaqësuesit e jashtëm, zyrtarët e jashtëm dhe punonjësit e jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare që kanë marrë dhe e kanë mbajtur statusin e përfitimit publik sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.3. rrogat e pranuar nga përfaqësuesit e jashtëm, zyrtarët e jashtëm dhe punonjësit e jashtëm të agjencive donatore, të kontraktorëve të tyre apo të fondacioneve që realizojnë ndihmën humanitare, punën e rindërtimit, administratën civile a ndihmën teknike në Kosovë;
- 1.4. rrogat e pranuar nga zyrtarët e jashtëm dhe zyrtarët e punësuar vendorë të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike, të cilat sipas këtij ligji do ta përfshijnë personelin e huaj dhe vendor të UNMIK-ut, siç saktësohet në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/47 të datës 18 gusht të vitit 2000 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it e të UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë. Të njëjtat përjashtime vlejnë për

institucionet ndërkombëtare financiare ndërqeveritare që kanë të drejtë dhe që janë të autorizuar sipas rregullit të cilat veprojnë në Kosovë;

1.5. rrogat e marra nga personeli i jashtëm i KFOR-it;

1.6. kompensimet për dëmtimin ose shkatërrimin e pronës;

1.7. të ardhurat nga poliset e sigurimit të jetës që paguhet si rezultat i vdekjes së personit të siguruar dhe

1.8. kthimin e parave ose kompensimin për trajtimin mjekësor dhe shpenzimet, duke përfshirë edhe hospitalizimin dhe mjekimin, pos rrogave të paguara gjatë periudhës së mungesës nga puna për shkak të sëmundjes ose lëndimit.

Neni 8 **Të ardhurat nga rrogat**

1. Në të ardhurat bruto nga rrogat përfshihen:

1.1. pagat e paguara në emër të një punëdhënësi për punën të cilën e kryen punonjësi sipas udhëheqjes së drejtorit ose punëdhënësit;

1.2. kompensimet, provizionet dhe format e tjera të kompensimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit ua paguan punonjësve mbi dhe përtej rrogës;

1.3. të ardhurat e fituara nga puna e përkohshme të cilën e kryen punonjësi;

1.4. të ardhurat nga punësimi i mundshëm, siç është nënshkrimi i një kompensimi të rrogës;

1.5. premitë e sigurimit shëndetësor dhe të jetës që një punëdhënës paguan për punonjësin;

1.6. falja e huas së punonjësit ose e obligimit të punëdhënësit;

1.7. pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit nga punëdhënësi dhe

1.8. pos nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj, përfitimet në mallra që një punëdhënës ia jep punonjësit që kalon shumën minimale të përcaktuar me një akt nënligjor që do të lëshohet nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

2. Në të ardhurat e përgjithshme nga rrogat nuk përfshihen:

- 2.1. kompensimi i shpenzimeve reale të udhëtimeve të biznesit deri në shumën që duhet të saktësohet me një akt nënligjor që duhet të lëshohet nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave;
 - 2.2. dëmshpërblimi për aksidentet në punë dhe
 - 2.3. përfitimet në mall të dhëna nga punëdhënësi për punonjësit e huaj për të lehtësuar jetesën e tyre në Kosovë, siç është banimi dhe pagesa e shkollimit;
3. Në të ardhurat e përgjithshme nuk përfshihen kontributet pensionale, si në vijim:
- 3.1. kontributet e dhëna nga punëdhënësi në emër të punonjësit në sistemin e kursimeve individuale pensionale, në fondin plotësues të pensionit të punëdhënësit dhe në skemën plotësuese individuale të pensioneve sipas Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës; dhe
 - 3.2. kontributet e dhëna nga punonjësi në sistemin e kursimeve individuale pensionale, në fondin pensional plotësues të punëdhënësit dhe në skemën plotësuese pensionale individuale sipas Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës.

Neni 9

Të ardhurat nga aktivitetet afariste

- 1 Të ardhurat e përgjithshme nga aktivitetet afariste do të thotë të marrurat e përgjithshme të krijuara nga personi fizik i angazhuar në aktivitete të tilla.
- 2 Në varësi të dispozitave të këtij neni, lejohen si zbritje nga të ardhurat e përgjithshme të krijuara nga aktivitetet afariste shpenzimet e paguara ose të shkaktuara gjatë periudhës së tatimit që janë tërësisht, vetëm dhe drejtpërdrejt të lidhura me kryerjen e aktiviteteve të tilla afariste.
- 3 Shpenzimet që përndryshe i plotësojnë kushtet e parashtruara në paragrafin 2 të këtij neni lejohen si zbritje, varësisht nga kufizimet në vijim:
- 3.1. shpenzimet e përfaqësimit mund të zbriten deri në shumën maksimale prej dy për qind (2%) të të ardhurave të plota të përgjithshme;
 - 3.2. borxhi i keq mund të zbritet vetëm nëse plotësohen tri (3) kushtet në vijim:
 - 3.2.1. shuma që korrespondon me borxhin më parë është përfshirë në të ardhura;
 - 3.2.2. borxhi është shlyer nga librat e tatimpaguesve si i pavlerë; dhe

3.2.3. ekziston dëshmi e përshtatshme e përpjekjeve të vërteta të pasuksesshme që janë bërë nga tatimpaguesi për ta mbledhur borxhin;

3.3. borxhi i keq që është mbledhur më pas përfshihet në të ardhura në kohën kur mblidhet;

3.4. shpenzimet për udhëtim, shujta, banesa, dhe shpërngulja kufizohen në shumat që duhet të saktësohen në udhëzimin administrativ që duhet ta nxjerrë Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe

3.5. kompensimi, interesi, qiraja dhe shpenzimet e tjera që i paguhen një personi të afërm janë të zbritshme në shumën e barabartë me shumën më të vogël të pagesës aktuale ose të vlerës së tregut.

4. Shpenzimet në pasuritë kapitale, përveç shpenzimeve për tokë, për vepra të artit dhe pronave të tjera që nuk i nënshtrohen konsumit, të cilat janë në pronësi të tatimpaguesit dhe shfrytëzohen për aktivitetet afariste të tatimpaguesit rimerren me kalimin e kohës përmes zbritjeve të zhvlerësimit sipas metodës së zvogëlimit të bilancit sipas shkallëve në vijim:

4.1. ndërtesat në shkallën prej pesë për qind (5%);

4.2. automobilat, pajisjet për zyrë dhe kompjuterë në shkallën prej njëzet për qind (20%) dhe

4.3. mjetet e tjera kapitale në shkallën prej pesëmbëdhjetë për qind (15%).

5. Nëse shumat e shpenzuara gjatë periudhës së tatimit për riparimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e mjeteve kapitale nuk e kalojnë pesë për qind (5%) të bilancit në llogari në fillim të vitit, shumat e tilla lejohen si zbritje për atë vit. Nëse shumat e tilla të shpenzuara tejkalojnë pesë për qind (5%), teprica e tillë konsiderohet si përmirësim dhe i shtohet llogarisë së kapitalit.

6. Shpenzimet për rritjen e vlerës së kontratave të qirasë që shfrytëzohen për aktivitetet afariste të tatimpaguesit rimerren përmes zbritjeve të zhvlerësimit që llogariten duke e shfrytëzuar metodën konstante me një periudhë që është e barabartë me jetëgjatësinë e kontratës së qirasë.

7. Tatimpaguesit me të ardhura nga shitja e mallrave, të cilët e mbajnë listën e artikujve për ta llogaritur çmimin e mallrave të shitura, e shfrytëzojnë metodën LIFO (i fundit që hyn brenda del i pari), FIFO (i pari që hyn brenda del i pari) ose ndonjë metode tjetër të tillë ashtu siç mund të parashtrohet në akt nënligjor që duhet të nxirret nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

8. Nëse shuma e zbritjeve të tatimpaguesit nga aktivitetet e biznesit për vitin e tatueshëm i kalon të ardhurat e tatimpaguesit nga aktivitetet afariste për atë vit, shuma e humbjes së tillë mund të bartet për deri në pesë (5) periudha të njëpasnjëshme tatimore dhe janë në dispozicion si zbritje ndaj çfarëdo të ardhurave gjatë atyre viteve. Nëse tatimpaguesi ka humbje në afarizëm për më shumë se një (1) vjet, humbjet janë të zbritshme sipas rendit në të cilin janë shkaktuar.

9. Nuk lejohet kurrfarë zbritje për:

9.1. shpenzimet e përvetësimit të tokës;

9.2. gjobat dhe ndëshkimet;

9.3. tatimin në të ardhura dhe tatimin e vlerës së shtuar për të cilat tatimpaguesi kërkon lirim ose kredi për tatimin në repromaterial sipas legjislacionit mbi tatimin në vlerë të shtuar;

9.4. shpenzimet personale, të jetesës ose ato familjare;

9.5. çfarëdo humbje nga shitja ose këmbimi i pronës ndërmjet personave të afërm dhe

9.6. shpenzimet për argëtim a rekreacion, përveç nëse janë shkaktuar në lidhje me afarizmin e ofrimit të aktiviteteve argëtuese ose rekreative nga tatimpaguesi.

10. Sipas këtij ligji nuk lejohet zbritja për çfarëdo shpenzimi, përveç nëse tatimpaguesi dokumenton në mënyrën e përshkruar në akt nënligjor që duhet të nxirret nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave se shpenzimi i tillë është bërë, qëllimin e shpenzimit dhe shumën e shpenzimit.

11. Tatimpaguesi me të ardhura të përgjithshme vjetore nga aktivitetet afariste që i tejkalon 50.000 euro për periudhën tatimore i mban librat dhe shënimet e identifikuar në paragrafin 14. të këtij neni.

12. Tatimpaguesi me të ardhura të përgjithshme vjetore prej pesëdhjetëmijë (50.000) euro ose më pak nga aktivitetet afariste për periudhën tatimore mund të zgjedhë t'i përgatisë librat dhe shënimet e identifikuar në paragrafin 14. të këtij neni.

13. Nga tatimpaguesi që zgjedhë t'i përgatisë librat dhe shënimet e identifikuar në paragrafin 14. të këtij neni për cilëndo periudhë tatimore kërkohet t'i përgatisë librat dhe shënimet e tilla për secilën periudhë pasuese tatimore.

14. Librat dhe shënimet që nevojiten sipas këtij neni janë si vijon:

14.1. libri i shitjes në të cilin përfshihet data e shitjes së mallrave ose e shërbimeve, sasia e mallrave të shitura ose e shërbimeve të ofruara, përshkrimi i mallrave ose i shërbimeve dhe të ardhurat e përgjithshme të plota;

14.2. libri i blerjes në të cilin përfshihet data e blerjes së mallrave ose e shërbimeve, sasia e mallrave ose e shërbimeve, përshkrimi i mallrave ose i shërbimeve, sasia e blerjes, emri i shitësit dhe numri i identifikimit i shitësit tatimpagues.

14.3. libri i shpenzimeve në të cilin përfshihet lista e të gjitha shpenzimeve që nuk janë shënuar në libër siç janë rogat, interesi dhe qiraja;

14.4. Ilogaria kapitale, nëse është e zbatueshme, që përfshinë bilancin e hapjes, shtimet në kapital, shpenzimet që do të kapitalizohen, shkallën e zhvlerësimit, shumën e zhvlerësimit, shitjet, bilancin e mbylljes;

14.5. çdo libër apo regjistrim tjetër që kërkohet sipas aktit nën ligjor të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 10 **Të ardhurat nga qiraja**

1. Të ardhurat bruto nga qiratë përfshijnë:

1.1. të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e pasurisë së patundshme sikurse janë ndërtesat, toka dhe apartamentet;

1.2. të ardhurat e fituara nga dhënia me qira e pajisjeve, automjeteve transportuese dhe llojeve tjera të pasurisë.

2. Lejohet si zbritje nga të ardhurat bruto nga qiraja një shumë e barabartë me:

2.1. shpenzimet reale të paguara apo të krijuara, tërësisht dhe ekskluzivisht për krijimin e qirasë së tillë, me kusht që regjistrimet për shpenzimet e tilla të mbahen në mënyrën e përshkruar në një akt nënligjor që lëshon Ministria e Ekonomisë dhe Financave apo

2.2. dhjet për qind (10%) të qirave të marra me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të riparimit, arkëtimit të pagesave dhe të shpenzimet tjera të paguara apo të krijuara gjatë marrjes së qirasë.

Neni 11 **Të ardhurat nga pasuria e paprekshme**

1. Të ardhurat bruto nga pasuria e paprekshme përfshijnë të ardhurat e krijuara nga patentet, të drejtat autoriale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuritë tjera që përbëhen vetëm nga të drejtat dhe që nuk kanë formë fizike.

2. Lejohen si zbritje nga të ardhurat bruto të krijuara nga pasuria e paprekshme, shpenzimet e paguara apo të krijuara me rast të krijimit të të ardhurave nga pasuria e paprekshme, me kusht që regjistrimet e shpenzimeve të tilla të jenë mbajtur në mënyrën të përshkruar në ndonjë akt nënligjor të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

3. Shpenzimet për pasuritë e paprekshme që kanë kohëzgjatje të kufizuar të përdorimit (patentët, të drejtat autoriale, licencat, vizatimet dhe modelet, kontratat, të drejtat ekskluzive) janë të zbritshme në formë të detyrimeve për amortizim. Metoda e amortizimit është metoda

lineare dhe pagesa bazohet në kohëzgjatjen e dobisë së pasurisë, ashtu siç përcaktohet në marrëveshjen ligjore që rregullon përvetësimin dhe përdorimin e pasurisë së paprekshme.

Neni 12

Të ardhurat nga interesi

1. Të ardhurat bruto nga interesi përfshijnë:

1.1. interesin nga huat e dhëna për personat fizikë apo subjektet (entitetet);

1.2. interesin nga flet obligacionet ose letrat tjera me vlerë të lëshuara nga autoritetet publike dhe organizatat afariste;

1.3. interesin nga llogaritë (e kursimeve) të cilat sjellin interes, e që mbahen në banka dhe në institucione të tjera financiare.

2. Të ardhurat bruto nga interesi nuk përfshijnë interesin (kamatën) nga mjetet e Trustit të Kursimeve Pensionale në Kosovë apo nga cilido fond tjetër pensional i përkufizuar sipas Ligjit për Fondet e Pensional të Kosovës.

Neni 13

Të ardhurat nga dividendët

1. Të ardhurat bruto nga dividendët përfshijnë dividendët dhe fitimin tjetër të shpërndarë për tatimpaguesin.

2. Të ardhurat bruto nga dividendët nuk përfshijnë dividendët e fituara nga mjetet e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës apo nga cilido fond tjetër pensional i përkufizuar sipas Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës.

Neni 14

Të ardhurat nga fitimet në kapital

1. Të ardhurat bruto nga fitimet në kapital nënkuptojnë fitimin që tatimpaguesi realizon nëpërmjet shitjes apo formave të tjera të tjetërsimit të pasurisë kapitale, duke përfshirë pasurinë e patundshme dhe letrat me vlerë.

2. Shuma e fitimit në kapital është dallimi pozitiv ndërmjet çmimit të shitjes së pasurisë dhe vlerës së pasurisë së kapitalit, siç përcaktohet në paragrafin 5. të këtij neni.

3. Çmimi i shitjes së pasurisë së kapitalit është shuma e çdo paraje të pranuar plus vlera e tregut e çdo pasurie tjetër, përveç parave të pranuar si pagesë për shitjen.

4. Nëse palët janë persona me ndonjë lidhje mes veti dhe çmimi i shitjes është më i ulët se çmimi i tregut, atëherë çmimi i shitjes do t'i përshtatet çmimit të tregut në mënyrën siç përshkruhet në akt nënligjor të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.
5. Vlera e pasurisë së kapitalit është shuma që tatimpaguesi ka paguar për përvetësimin e pasurisë, e rritur për vlerën (koston) e përmirësimeve dhe e zvogëluar nga zhvlerësimi dhe shpenzimet tjera që lejohen me këtë ligj.
6. Humbja në kapital nënkupton humbjen që e pëson tatimpaguesi nëpërmjet shitjes apo ndonjë forme tjetër të tjetërsimit të pasurisë së kapitalit, duke përfshirë pasurinë e palëvizshme dhe letrat me vlerë.
7. Shuma e humbjes në kapital është dallimi negativ ndërmjet çmimit të shitjes së pasurisë dhe vlerës së pasurisë së kapitalit.
8. Humbjet në kapital trajtohen si humbje të zakonshme nga aktivitetet afariste (të biznesit), të cilat mund të zbriten nga të ardhurat në vitin aktual. Nëse shuma e humbjes në kapital për vitin e tatueshëm tejkalon shumën e të ardhurave të tatimpaguesit për atë vit, shuma e tejkalimit të humbjes së tillë, krahasuar me të ardhurat e vitit aktual, mund të bartet përpara deri në pesë (5) periudha tatimore të njëpasnjëshme dhe vihet në dispozicion si zbritje në çdo të ardhur gjatë këtyre viteve.
9. Të ardhurat bruto nga fitimet në kapital nuk përfshijnë fitimet në kapital të realizuara nga shitja e mjeteve të Trustit të Kursimeve Pensionale në Kosovë apo cilitdo fond tjetër pensional të përkufizuar me Ligjin për Fondin Pensional të Kosovës.
10. Ky nen do të hyjë në fuqi më 1 janar 2010.

Neni 15 **Të ardhurat tjera**

Të ardhurat bruto përfshijnë çdo formë tjetër të të ardhurave nga çfarëdo burimi, siç janë të ardhurat nga lotaria ose nga fitimet në lojërat e fatit, apo të ardhurat nga faljet e borxheve.

Neni 16 **Zbritja e kontributeve bëmirëse**

1. Kontributet që bëhen për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, të mbrojtjes së ambientit dhe sportive, sipas këtij ligji lejohen si zbritje me vlerë maksimale prej pesë për qind (5%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribut bamirës.
2. Kontributet bamirëse sipas paragrafit 1. të këtij neni. duhet të bëhen për:

2.1. një organizatë të regjistruar sipas legjislacionit për regjistrimin dhe funksionimit OJQ-ve, si një organizatë joqeveritare që ka marrë dhe mban statusin e përfitimit publik;

2.2. çdo organizatë tjetër jo komerciale që drejtpërsëdrejti kryen veprimtari jo profitabile që janë të interesit publik, sikurse janë:

2.2.1. institucionet mjekësore;

2.2.2. institucionet arsimore;

2.2.3. organizatat për mbrojtjen e ambientit;

2.2.4. institucionet fetare;

2.2.5. institucionet që kujdesen për personat e paaftë ose të moshuar;

2.2.6. jetimoret; dhe

2.2.7. institucionet që nxisin krijimin e shkencës, kulturës, sporteve apo arteve.

3. Kontributi bamirës nuk përfshinë kontributin që është në dobi të drejtpërdrejtë të donatorëve apo të personave të tjerë që kanë lidhje me donatorin.

4. Çdo tatimpagues, i cili kërkon zbritje për kontributin bamirës duhet ta dorëzojë një deklaratë vjetore dhe të sigurojë faturën (dëftesën) në lidhje me atë kontribut, në mënyrën siç përshkruhet akt nënligjor të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 17

Ndalja e tatimit në paga

1. Secili punëdhënës është përgjegjës për ndaljen e tatimit nga të ardhurat bruto të pagave të të punësuarave të tij gjatë secilës periudhë të listë pagesave.

2. Një punëdhënës, i cili është punëdhënësi kryesor i një të punësuarit, ndalë një shumë për periudhën e duhur të listë pagesave, në përputhje me tabelat për këso ndaljeje tatimesh (mbajtje në burim), siç parashtrohet në akt nënligjor të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave. Tatimi provues (tentativ) për muajin e caktuar zbritet për shumën e ndalur (mbajtur në burim) nga punëdhënësi kryesor për muajin e mëparshëm të vitit.

3. Punëdhënësi, i cili nuk është punëdhënës kryesor i të punësuarit, ndalë shumën e barabartë me dhjet për qind (10%) të pagave për secilën periudhë tatimore.

4. Secili punëdhënës dorëzon deklarimin (pasqyrën - certifikatën) e tatimit të ndalur nga paga (mbajtur në burim) dhe e transferon shumën e tatimit të ndalur nga paga (mbajtur në burim) në

llogarinë e një banke të licencuar nga BPK, por të caktuar nga Administrata tatimore, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me akt nënligjor të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

5. Secili punëdhënës që bën pagesa të pagave gjatë periudhës tatimore ia dorëzon Administratës tatimore një pasqyrë vjetore të pagesës së tatimit deri më 31 janar të vitit pasues të periudhës tatimore, me informata rreth pagave të paguara dhe tatimit të papaguar dhe të shlyer për secilin punëtor, në përputhje me formën dhe procedurat e cekura në akt nënligjor të lëshuar që do të nxjerrët nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

6. Secili punëdhënës i siguron çdo punëtori nga paga e të cilit është ndalur tatimi në pagë (mbajtur në burim tatimi në paga), një certifikatë për ndalimin nga paga (mbajtjen në burim) deri më 1 mars të vitit që pason periudhën tatimore, në formën e cekur në akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 18

Ndalja (mbajtja në burim) e tatimit mbi interesat

1. Secili autoritet publik, organizatë biznesi, bankë apo institucion financiar tjetër, që bën pagesë të interesit, ndalë tatimin (mbanë tatimin në burim) në shumën e barabartë me dhjet për qind (10%) për çdo shumë të paguar apo të kredituar të interesit

2. Secili autoritet publik, organizatë afariste (biznesi), bankë apo institucion tjetër financiar, dorëzon një deklaram (pasqyrë) të tatimit të ndalur (mbajtur në burim) dhe dërgon shumën e tatimit të ndalur (mbajtur në burim) në llogarinë e një banke të licencuar nga BQK, e të caktuar nga Administrata tatimore, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me akt nënligjor të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

3 Secili autoritet publik, organizatë afariste, bankë apo institucion tjetër financiar që paguan interes gjatë periudhës tatimore, me rast të kërkesës dorëzon një certifikatë për ndaljen e shumës së tatimit (mbajtjen në burim) deri më 1 mars të vitit që pason periudhën tatimore, në formën e cekur në akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 19

Ndalja e tatimit mbi dividendë

1. Secila organizatë afariste që bën pagesë të dividendëve ndalë tatimin në një shumë të barabartë me dhjetë për qind (10%) të secilës shumë të dividendit të paguar apo të kredituar.

2. Secila organizatë afariste dorëzon një deklaratë për tatimin e ndalur dhe ridërgon shumën e tatimit të ndalur në një llogari të caktuar nga Administrata tatimore në një bankë të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me aktin nënligjor i cili do të lëshohet nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

3. Secila organizatë afariste, që paguan dividendë gjatë periudhës tatimore, në rast të kërkesës dorëzon deri më 1 mars të vitit pasues të periudhës tatimore një certifikatë për tatimin e mbajtur (të papaguar) sipas formës së cekur në aktin nënligjor i cili do të lëshohet nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 20

Ndalja e tatimit mbi fitimet e lotarisë

1. Secili organizator i lotarisë apo i një loje të fatit ndalë tatimin në shumën e barabartë me dhjet për qind (10%) nga secila pagesë e fitimit.
2. Secili organizator i lotarisë apo i lojës së fatit dorëzon një deklaratë të tatimit të ndalur dhe e ridërgon shumën e tatimit të ndalur në një llogari të caktuar nga Administrata tatimore në një bankë të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me aktin nënligjor i cili do të lëshohet nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.
3. Secili organizator i lotarisë apo i lojës së fatit gjatë periudhës tatimore, pas kërkesës, dorëzon një certifikatë për ndaljen e shumës së tatimit deri më 1 mars të vitit pasues të periudhës tatimore në formën e cekur në akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 21

Pagesa e tatimit për veprimtaritë afariste

1. Secili tatimpagues i cili realizon të ardhura nga veprimtaritë afariste paguan tatimin çdo tre muaj në një llogari të caktuar nga Administrata tatimore në një bankë të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujshi kalendarik (15 prill, 15 korrik, 15 tetor, 15 janar).
2. Shuma për secilën pagesë tremujore të tatimit sipas paragrafit 1 të këtij neni është si vijon:
 - 2.1. tatimpaguesit me pesëmijë (5.000) euro, apo më pak të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste tridhjeteshtatë pikë pesë (37.5) euro për tremujor;
 - 2.2. tatimpaguesit me mbi pesëmijë (5.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste, prej të cilëve nuk kërkohet dhe që nuk vendosin t'i mbajnë librat dhe regjistrimet e përmendura në paragrafin 14. të nenit 9 të këtij ligji:
 - 2.2.1. tre për qind (3%) të të ardhurave bruto nga tregtia, transporti, bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale të çdo tremujori;

2.2.2. pesë për qind (5%) të të ardhurave bruto nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori.

2.3. tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore që tejkalojnë pesëdhjetëmijë (50.000) euro, nga veprimtaritë afariste, prej të cilëve nuk kërkohet dhe që nuk vendosin t'i mbajnë librat dhe regjistrimet e përmendura në nenin në paragrafin 14. të nenit 9 të këtij ligji:

2.3.1. një të katërtën (1/4) e detyrimit tatimor të përgjithshëm për periudhën aktuale tatimore duke u bazuar në të ardhurat e tatueshme të llogaritura; apo

2.3.2. për periudhën e dytë tatimore dhe ato pasuese, për të cilat tatimpaguesi bën pagesën sipas këtij paragrafi, një të katërtën (1/4) e 110% të detyrimit tatimor të përgjithshëm për periudhën tatimore që i paraprinë periudhës aktuale tatimore.

3. Nëse pagesat e kësteve tremujore bëhen në datat e caktuara ose para atyre dhe nëse pagesa përfundimtare bëhet siç kërkohet me në paragrafin 5. të nenit 26 të këtij ligji, nuk aplikohet interesi apo dënimet për pagesa të pamjaftueshme, nëse:

3.1. dallimi ndërmjet shumës që kërkohet në çdo këst tremujor dhe shumës së paguar për çdo këst nuk tejkalon dhjetë për qind (10%) të shumës së duhur ose

3.2. pas periudhës tatimore 2005 dhe pas periudhës së parë tatimore të tatimpaguesit, shuma e paguar në çdo këst është dhjetë për qind (10%) më e lartë se një e katërta (¼) e tatimit të vlerësuar nga Administrata tatimore për periudhën paraprake tatimore.

Neni 22

Pagesa e tatimit për qiratë

1. Secili tatimpagues, i cili merr të ardhura nga qiraja, paguan çdo tremujor në vit tatimin në llogarinë e caktuar nga Administrata tatimore në një bankë të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik (15 prill, 15 korrik, 15 tetor, 15 janar).

2. Shuma e secilës pagesë tremujore, sipas paragrafit 1. të këtij neni, është dhjetë për qind (10%) e të ardhurave të tatueshme të marra nga qiraja në tremujorin kalendarik që është menjëherë para datës së pagesës, e zvogëluar për cilëndo shumë të parave të ndalura gjatë këtij tremujori, në përputhje me paragrafin 2. të nenit 27 të Ligjit për tatimet mbi të ardhurat e korporatave.

Neni 23
Pagesa e tatimit për pasurinë e paprekshme

1. Secili tatimpagues, i cili merr të ardhura nga pasuria e paprekshme, katër herë në vit paguan tatimin në llogarinë e një banke të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës të caktuar nga Administrata tatimore, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik (15 prill, 15 korrik, 15 tetor, 15 janar).

2. Shuma e secilës pagesë tremujore sipas paragrafit 1. të këtij neni është dhjetë për qind (10%) e të ardhurave të tatueshme nga pasuria e paprekshme të realizuara në tremujorin kalendarik menjëherë para datës së pagesës.

Neni 24
Pagesa e tatimit nga fitimet në kapital dhe nga të ardhurat tjera

Secili tatimpagues, i cili merr të ardhura nga fitimet në kapital ose nga çdo burim tjetër, që nuk përshkruhet në nenet 17 deri 23 më sipër, paguan tatimin më 1 prill ose para 1 prillit të vitit pasues të periudhës tatimore, në përputhje me dispozitat e parashtruara në nenin 26 të këtij ligji.

Neni 25
Kreditet në tatim

1. Tatimpaguesit mund të kreditojnë shumat në tatimin që e kanë borxh sipas nenit 5 për vitin e tatueshëm, si në vijim:

1.1. shumat e ndalura gjatë periudhës së njëjtë tatimore sipas neneve 17 deri 20 të këtij ligji dhe paragrafit 2. të nenit 27 të Ligjit për Tatimin në të ardhurat e korporatave;

1.2. pagesat e tatimit sipas neneve 21, 22 apo 23 të këtij ligji;

1.3. tatimet në të ardhura të paguara në cilindo shtet të huaj, nëse të ardhurat për të cilat paguhet tatimi i huaj i nënshtrohen tatimit sipas këtij ligji. Shuma e kreditit të tatimit të huaj kufizohet në shumën e tatimit që do të paguhej për të ardhura të tilla sipas këtij ligji.

Neni 26
Deklaratat tatimore dhe pagesat

1. Përveç rasteve ku vlejnë paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni, të gjithë tatimpaguesit duhet të përgatisin një deklaratë tatimore vjetore më 1 prill ose para 1 prillit të vitit që pason periudhën tatimore. Deklarata bëhet në formularët e paraparë nga Administrata tatimore dhe përfshinë, mes tjerash, të ardhurat bruto nga të gjitha burimet, zbritjet e lejueshme, të ardhurat e tatueshme dhe tatimin për t'u paguar në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

2. Tatimpaguesit që pranojnë apo që u mblidhen të ardhurat prej vetëm një apo më shumë burimeve të cekura në vijim, nuk duhet t'i dorëzojnë deklaratën vjetore:

2.1. pagat;

2.2. aktivitetet afariste për të cilat paguhet tatimi sipas nën-paragrafëve 2.1. dhe 2.2. të paragrafit 2. të nenit 21 të këtij ligji

2.3. qiraja, kur bëhet zbritja në përputhje me nën-paragrafin 2.2. të paragrafit 2. të nenit 10 të këtij ligji;

2.4. interesi;

2.5. dividendët;

2.6. pagesat e lotarisë apo të lojërave të tjera të fatit;

2.7. të ardhurat nga prona e paprekshme.

3. Tatimpaguesit, të ardhurat e tatueshme të të cilëve janë më pak se njëmijë (1.000) euro kur të llogariten sipas këtij ligji, nuk duhet t'i dorëzojnë deklaratë vjetore.

4. Tatimpaguesit, të cilët pranojnë apo u mblidhen të ardhurat vetëm nga burimet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni, apo të ardhurat e tatueshme të të cilëve janë më pak se njëmijë (1.000) euro, mund të zgjedhin që të përgatisin dhe dorëzojnë deklaratën vjetore më 1 prill apo para 1 prillit të vitit që pason periudhën tatimore. Deklarata bëhet në formularët e paraparë nga Administrata tatimore dhe përfshinë, mes tjerash, të ardhurat bruto nga të gjitha burimet, zbritjet e lejueshme, të ardhurat e tatueshme dhe tatimin për t'u paguar në përputhje me nenin 5 të këtij ligji. Në llogaritjen e të ardhurave të tatueshme në deklaratën e tillë, tatimpaguesit të cilët kanë paguar tatim mbi të ardhurat afariste sipas nën-paragrafëve 2.1. dhe 2.2. të paragrafit 2. të nenit 21 të këtij ligji do t'u lejohet një zbritje në shumë prej 25% të të ardhurave bruto.

5. Tatimpaguesit prej të cilëve kërkohet dorëzimi i deklaratës tatimore vjetore, së bashku me atë deklaratë dorëzojnë shumën përfundimtare të tatimit që duhet të paguhet. Shuma përfundimtare e tatimit që duhet të paguhet është dallimi ndërmjet shumës së përgjithshme të tatimit të papaguar për periudhën tatimore të përcaktuar në përputhje me këtë ligj dhe shumës së përgjithshme të kredive në tatim sipas nenit 25 të këtij ligji.

6. Në qoftë se shuma e përgjithshme e kredive në tatim, në përputhje me nenin 25 të këtij ligji e tejkalon shumën e përgjithshme të tatimit të papaguar për periudhën tatimore, tatimpaguesi ka të drejtë në kompensimin e tatimit shtesë të paguar.

7. Vendi për dorëzimin e deklaratave tatimore, tatimit të ridërguar dhe për kërkimin e kompensimit përcaktohet në një akt nënligjor që do të lëshohet nga Ministri i Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 27
Zbatimi

Ministri i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 28
Ligji në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligj shfuqizohet çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë ligj.
2. Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2009. me përjashtim të nenit 14 që hyn në fuqi më 1 janar 2010.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2009.

Ligji Nr. 03/ L-115
18 dhjetor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI